

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
RENTAL CAR DRIVEAWAY SH.P.K.

Ne Tirane, sot me dt 01.05.2023 (dymije e njezete e tre), shtetasit:

Z.Arben Kernaja lindur më 10.02.1973 në Kernajë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i Leternjoftimit me numer 033060216 dhe numer personal H30210294M madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Z.Pëllumb Bisheva lindur më 11.10.1999 në Barjam Curri, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i Pashaportes me numer BA9623845 dhe numer personal J91011040L madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Te cilet duke u bazuar dhe në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, 'Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare', ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte "Shoqeria"), me dispozitat e mëposhtme.

Neni 1

Emërtimi dhe selia e shoqërisë

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **RENTAL CAR DRIVEAWAY SH.P.K.**

- 1.1 Selia e shoqërisë ndodhet në eshte Rruga "Sami Frasherit", Qendra Metropol, Kati 2, hyrja 1, Ap 13.1, Tirane. 1001, Shqipëri. Në këtë adresë ndodhet edhe Zyra Qëndrore e Shoqërisë.
- 1.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Objekti i Shoqërisë

2.1 Objekti i Shoqërisë është :

Makina me qira, Shitblerje makinash, Agjenci Udhetimi, Tregëtim me pakice mallrave industrial, Servis makinash, Lavazh. Sherbim Karrotrec.

Aktivitetin e saj kjo firme mund ta ushtroje si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj Aktiviteti i shoqerise nuk do te kufizohet vetem ne keto sherbime apo veprimtari.

2.2 Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara mund të bashkëpunojë me direkt dhe indirekt me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog osë të lidhur me të tyren.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë. Viti ushtrimor


- 3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat te pacaktuar.
- 3.2 Viti i parë financiar do të fillojë nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregëtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë dhe do të përfundojë në 31 Dhjetor.
- 3.3 Vitet e mëtejshme financiare fillojnë më 1 Janar dhe përfundojnë me 31 Dhjetor.

Neni 4

Kapitali themeltar

4.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 500.000 Lekë (pesesqind mije Lekë) dhe përbëhet tërësisht nga kapital në para. Pjesëmarrja e Ortakeve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- a. Ortaket themelues Z. Arben Kernaja Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 255,000 (dyqindpesedheteepese mije) Lekë që përben 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.



- b. Ortaket themelues Z. Pëllumb Bisheva Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 245,000 (dyqindedyzetepese mije) Lekë që përben 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë

4.2 Kapitali themeltar perbehet nga 2 (dy) kuota .

Neni 5
Asambleja e Përgjithshme

5.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e përcaktuara në Ligjin per Shoqerte tregtare . Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet dhe sipas mënyrës së thirrjes të përcaktuara në statusin e shoqërisë.

Neni 6
Administratori

6.1 Shoqëria do të administrohet nga një Adminstrator. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Z.Pëllumb Bisheva Afati i emërimit të Administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Neni 7
Kostot e themelimit

7.1 Të gjitha kostot, pagesat dhe shpenzimet lidhur me themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë do të merren përsipër nga shoqëria të cilat do të përfshihen në llogarinë e parë vjetore financiare në shumën e atyre aktuale.

Neni 8
Njoftimet

8.1 Njoftimet për oratakët do të kryhen me postë të regjistruar në adresën e kompanise më të fundit të komunikuar nga cdo ortak, me përjashtim kur parashikohet ndryshe nga ligji apo statuti.

8.2 Njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet postës elektronike, në momentin e krijimit të ksuhteve teknike që kërkohen sipas ligjit.

Neni 9
Dispozita të fundit

9.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë akt themelimi, me statutin e saj dhe ligjin shqiptar.


Neni 10
Kopje

10.1 Ky akt themelimi hartohet në 3 kopje, sipas këtij destinacioni, nje kopje orataku, një kopje për Qendrën Kombetare të biznesit dhe një kopjë për zyrën qendrore të shoqërisë.

O R T A K E T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

RENTAL CAR DRIVEAWAY SH.P.K.

ARBEN KERRNAJA



PËLLUMB BISHEVA

